



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:227602

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06344614

E.nr. 562/09

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NLB Prishtina (trashëgimtare juridike e Kasabanka) sh.a me seli ne Prishtinë, Rr. “Rexhep Luci”, nr.5, kundër debitorëve: I. S., rruga “F V.”, nr. ..., M., V. Dj. rruga “K. J.” nr. .. L... dhe D. T. rruga “R. C.” nr. ...M., propozim për përmbarim borxhi, vlera 732.49 €, jashtë seance me dt. 24.10.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET i tërhequr propozimi për përmbarim me numër E.nr. 562/09 i datës 07.05.2013 i kreditorit NLB Prishtina (trashëgimtare juridike e Kasabanka) sh.a me seli ne Prishtinë, kundër debitorëve: I. S., rruga “F V.”, nr. ..., M., V. Dj. rruga “K. J.” nr. .. L... dhe D. T. rruga “R. C.” nr. ...M., lidhur me pagesën e borxhit, lejuar me aktvendimin E.nr. i datës ...

A r s y e t i m

Kreditori në këtë gjykatë me datë 21.07.2009, ka ushtruar propozim kundër : I. S., rruga “F V.”, nr. ..., M., V. Dj. rruga “K. J.” nr. .. L... dhe D. T. rruga “R. C.” nr. ...M., propozim për përmbarim borxhi, vlera ... €

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me aktvendimin E.nr.562/09 me datë 07.05.2013 ka lejuar propozimin për përmbarim kundër debitorëve : I. S., rruga “F V.”, nr. ..., M., V. Dj. rruga “K. J.” nr. .. L... dhe D. T. rruga “R. C.” nr. ...M.

Me datën 22.02.2024 gjykata ka derguar propozimin për përmbarim te debitorët mirëpo nga flet kthesa është konstatuar se pala I. S. dhe pala D.T., janë te panjohur ne atë adrese dhe V.Dj. është shpërngulur nga adresat e tyre.

Andaj për të vepruar më tutje lidhur me këtë çështje përmbarimore, kreditori është obliguar që brenda afatit ligjor prej 3 ditësh, pranë kësaj gjykate të dorëzoj adresën e sakte të debitorëve : I. S., rruga “F V.”, nr. ..., M., V. Dj. rruga “K. J.” nr. .. L... dhe D. T. rruga “R. C.” nr. ...M., me qellim të procedimit të mëtutjeshëm në këtë çështje përmbarimore, duke e paralajmëruar edhe për pasojat se nëse nuk veprohet sipas udhëzimeve në konkluzion, gjykata propozimin për përmbarim do ta konsideroj se është tërhequr, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të

caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hidhet poshtë.

Andaj, Gjykata duke e marrë parasysh se kreditori nuk veproi sipas konkluzionit E.nr.562/09 të datës 26.08.2024 të kësaj gjykate, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u mbështetur në nenin 17 të LPP-së e në lidhje me nenin 99 dhe 102 paragrafi 3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
E.nr.562/09, datë 24.10.2024

Gjyqtari,

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit Prishtinë.